



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e pesëmbëdhjeta e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **27.06.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 16. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 17. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 22. <u>Lavdiye Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 11. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkyetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të, monitoruesja nga DEMOS - KDI, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Procesverbali

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Hap punimet për mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft – Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Istogut;
4. Shqyrtimi dhe Miratimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026;
5. Shqyrtimi dhe Miratimi i listës për projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2023;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi?

Floriana Maxharraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, thekson bazën ligjore për të drejtat e anëtarëve për propozime, ne si Komitet për Barazi Gjinore paraqesim këtë propozim. Një nga kategoritë me të ndjeshme në shoqërinë tone pa dyshim që janë grat dhe fëmijët, ne si Komunë dhe Kuvend Komunal e kemi për obligim që nëpërmjet iniciativave të mbështesim këto kategori. Prandaj bazuar edhe në praktiken që shumë komuna të Kosovës e implementojn projektin mbështetje për nënat lehona propozojmë që Kuvendi i Komunës të miratoj që secila nënë lehona të mbështetet me 300 euro nga buxheti i Komunës, forma e aplikimit mund të hartohet pas aplikimit të këtij vendimi.

Fjolla Ukaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, si anëtarë e komitetit për barazi gjinore duke par nga afër punën dhe aktivitetet të cilat i zhvillon zyra për barazi gjinore si dhe aktivitetet dhe tryezat e ndryshme të cilat i zhvillon zyrtarja në kuadër të kësaj zyre është edhe zyrtarja për të drejtat e fëmijëve dhe kjo zyre operon me një buxhet prej 5000 euro buxhet vjetor. Atëherë unë si anëtarë nga ky komitet propozoj që kësaj zyre ti shtohet një buxhet prej 3000 euro, ku do të thotë në total ti ketë 8000 euro në vit.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa, z. Genv Ademaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, këto propozime mund ti bëni të KAB- i dhe aty hynë.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka tjetër,
Me këto dy propozime që do të propozohen në piken e katërt të rendit të ditës në KAB,
Hedh në votim rendin e ditës
Miratohet unanim rendi i ditës për këtë mbledhje.
Konstatohet që 25 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit - në mbledhje mungojnë: Qerim Rexhaj, për arsye shëndetësore.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Agron Gashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, fjalimi im nuk është i shënuar, kam folur 15 minuta për Planin Zhvillimor për Arsim kam jep disa vërejtje dhe sugjerime aty nuk ka asgjë të shënuar.

Kryesuesi i Kuvendit – pyet nëse ka edhe dikush diçka,
Pasi q nuk keni diçka,
Hedh në miratim
Miratohet unanim me vërejtje
Konstatohet që me 25 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 26.06.2023 me vërejtje.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e radhës, Shqyrtimi dhe miratimi i Draft – Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Istogut.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Draft – Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Istogut.

Agron Gashi – e kam par edhe planin që ka ardhur për votim dhe kam par se disa rekomandime janë 12 rekomandime nuk janë përfshirë në këtë plan. Kështu që plani ka ardhur me u votuar dhe pas debatit publik nuk është ndryshuar asgjë në këtë plan. Ky Plan është gjysmak është teorik sepse nuk ka përfshirë shumë kërkesat tona ose kërkesat të cilat e zhvillojnë arsimin në Istog sepse tema e këtij plani është Zhvillimi në Istog. Kështu që me shumë ka pasur trajnime dhe ndarje të buxhetit pa nevojë se diçka që e prek thelbesisht ndryshimin e arsimit në Istog duke filluar nga politizimi i shkollave që është gjendura në

raport, duke filluar nga gjimnazi si shkolla elite që nuk është përmendur fare në këtë raport pastaj ngecjes në rezultate të arritshmeris ose diçka janë dhen disa kërkesa të politizimi. Rrënja e numrit të nxënësve nuk është çështja vetëm ikja jashtë vendit por rrënja e numrit të nxënësve është që po ikin në shkolla tjera duke filluar nga shkolla e mjeksis në Peje e shkollat tjera. Pastaj mungesa e kabineteve të TIK-ut ka qen premtim publik për digjitalizimin e të gjitha shkollave ku flitet për pak pajisje të TIK-ut është premtuar krejt digjitalizimi , ne në këtë raport e shohim ve 20% të shkollave kanë qasje në internet. Mandej gjimnazi si shkolla elitë nuk është parapara me e rrit cilësinë aty që me shkua nxënëset e me e rrit suksesin edhe në teste të maturës edhe në teste të arritshmeris që I keni përmendur në raport.

Pastaj krijimi I një qendre për këshillim dhe orientime të cilën e kam cekur edhe me pare, këto janë disa trajnime ku pa këto trajnime nuk rregullohet asgjë. Pastaj shkolla profesionale është trajtuar pak dhe ato disa drejtime të përgjithshme nuk janë profilizuar mire këto drejtime të shkollës teknike që ka qen edhe një premtim për bashkëpunim me bizneset nuk është caktuar buxhet për ndarjet e tyre me ju paguar praktikat me I shti në sistem të punës. Pastaj flitet për arritjet mesatare në test të arritshmeris nga 50 në 60% nuk është treguar si mund ta arrin këtë me çfarë mekanizmash. Është përmendur raporti kompjuter nxënës ku flit 1 -15 nëse ne kemi folur për digjitalizim komplet po me duket që një numër i vogël I kompjuter 10 nxënës në shkollat tona. Fokus me i madh i përfshirjes së nxënësve në të gjitha nivelet sidomos në nivelet parashkollor të fushatat vetdisuese tek çerdhet ju kam thënë edhe atë ditë që fushata vetdisuese nuk funksionon tek çerdhet dhe nuk ki vend në çerdhe kështu që me e gjet naj mënyre me krijuar çerdhe të reja me bë vende të lira e kam par atje disa shkolla me i përgatit me klasa të reja me parashkolloret por edhe pjesa e çerdhes ka kërkesa shumë në Istog për me i dërguar fëmijët në çerdhe nuk ka vend. Mos funksionimi i këshillave drejtues të shkollave mos funksionimi I aktiveve profesionale me jua dhen pak një zgjidhje këtyre e jo veç me i përmend trajnimet, por këshilli drejtues duhet me funksionuar dhe s' duhet të jetë në raport hiq.

Ndarja e buxhetit dhe fillimi i një platforme për fillimin e korikules së re ne e dimi që kurikula e re është në zbatim është me shumë në ngritje të cilësisë në trajnime e pjesë tjera ku kurikulen nuk është dashtë me e përmendur këtu hiq sepse normalisht ajo duhet me u zbatuar pa të nuk bën hiq.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, rreth kësaj pika ka me diskutuar mjaft por faktikisht ky është draft Plani Zhvillimor si çdo plan tjetër ka nevoja për plotësime dhe për kërkesa shtesë, dhe këtu ka shumë çka për tu plotësuar janë përcaktuar në 5 fusha janë mjaft të qëlluara duhet falënderuar të gjithë ekipin që kanë punuar në këtë plan gjithashtu edhe drejtorin me ekipin menaxhuar. Pikërisht në fushën e pare të menaxhimi I arsimit dhe anatomia e shkollës isha fokusuar tek menaxhimet i shkollës e sidomos tek zgjedhja e drejtorëve dhe zv.drejtorve, pra ju kisha lut që përzgjedhja e këtyre drejtorive të mos behet në baza politikes deri me tani e dimi që drejtoret janë emërtuar në baza politike por të ndryshohet të shihet kontributi dhe puna e punëtorit ose e kandidatit I cili faktikisht është për me e menaxher arsimin jo te shkoj nga ajo të cilin subjekt politik vjen të shihet puna dhe kontributi si dhe përvoja shumë vjeçare e tyre mendoj që në këtë mënyra rreth kësaj fushe ju kërkoj që mos të zgjidhen pikëpamje politike por të shihet të analizohet në detaje kontributi i personit i cili do të jetë menaxher qofte Drejtor apo zv.drejtor. sa I përket zhvillimit të cilësisë dhe zhvillimit profesional i mësimdhënësve e laburoj edhe Agroni në përgjithësi por unë do të isha ndalur në menaxhimi e procesit mësimor duke u nisur nga inspektorët nga vlerësimi i brendshëm fillimisht nga shkolla mandej nga DKA-ja të këtë një menaxhim pak ma të shpeshtë. Fokusin e kam të niveli qendror i cili nuk ka ber

mjaftueshëm për emërtimin e inspektoreve se di ku qëndron problemi ndoshta janë implikimet buxhetore por për me e pas një cilësi me të mirë unë konsideroj se shumica janë nga niveli qendror të përcaktuar se paku jo një ekip se ku me dit çfarë por se paku nga një për secilën fushë veç e veç sepse me inspektim të profesionit mendoj se ja qet vetit një objektiv se me dal sa ma mirë. Me herët kemi pasur inspektor të cilët e kanë matur performancën e mësimdhënësit jo vetëm brenda shkollës nga DKA-ja por performancë të mësimdhënësit është dhen edhe nga inspektoret.

Propozoj që pikërisht duke u nisur nga niveli qendror me i pas kërkesat nga drejtori i arsimit, me be kërkesa në nivel qendror që mu rrit numri i inspektoreve.

Sa i përket zbatimit të korikules së re mendoj së për korikul janë zbatuar dhe harxhuar mjaft, janë trajnuar 35 trajnime me sa di unë është menaxhuar deri dikund se si po zbatohet korikula mbi të gjitha edhe një faktor që ndikon janë edhe kordinatorët e shkollave që faktikisht janë së bashku me drejtor si inspektues neper orët mësimore.

Hajrush Shoshi – përshëndet të gjithë të pranishmit, falënderoj ekipin punues për këtë punë kaq të mirë kam për të shtuar diçka rreth këtij plani, disa propozime nëse e shohin të arsyeshme edhe ekipi dhe asamblistët: faqe 14 -15) të krijohet një staf I beueshem I drejtorve dhe zv.drejtorve kerkoj që të hiqet kjo pjesë.

Përkundër mundësive që duhet shfrytëzuar, politizimi eventual i emërimeve të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave, mungesa e mbikëqyrjes së vazhdueshme të institucioneve arsimore, mungesa e buxhetit për të plotësuar të gjitha nevojat e shkollave, paraqesin një rrezik permanent për cilësinë e menaxhimit dhe qeverisjes së institucioneve edukative-arsimore, prandaj është me rëndësi të kompletohet kuadri i zyrtarëve të nevojshëm në DKA, të krijohet një sistem i besueshëm i emërimit të drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve, dhe të arrihet funksionalizimi i plotë i këshillave drejtues të shkollave. Në këtë pike besoj që komuna nuk ka as një kompetencë që të ndërroj procedurat e zgjedhjes së drejtorve apo zv drejtorve. Prandaj propozoj që të hiqet nga teksti i PZHA.

Faqe 22, Masa 1 pika 4. Reforma kurrikulare kërkon qasje të punës ekipore të mësimdhënësve në proceset e planifikimit dhe të zbatimit të kurrikulës së re, si dhe shkëmbim të vazhdueshëm të përvojës ndërmjet tyre. DKA do të kujdeset që të formoj aktivet profesionale në nivel të lokaliteteve, që se paku 3 apo 4 shkolla të formojnë aktivet profesionale.

Masa 1 pika 5. Në këtë drejtim, DKA fillimisht do të bëjë një analizë të gjendjes me pedagog dhe psikolog në shkolla, funksionimin e ekipeve profesionale, pastaj do të bëjë një plan të zbatueshëm për rritjen e numrit të psikologëve dhe pedagogëve ku synimi kryesor do të jetë që çdo shkollë të ketë nga një psikolog ndërsa do të vlerësohet edhe në cilat shkolla duhet të kenë edhe pedagogun punësimin e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla.

Faqe 23, Masa 1 pika 7. Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog në bashkëpunim me MASHT, mbi bazën e një analize të hollësishme, duke marrë parasysh të dhënat mbi gjendjen infrastrukturore, trendët demografike në nivel komune dhe në bazë të kontekstit e veçantive lokale, do të bëjë planifikimin e rrjetit të shkollave (Rishikimi i funksionimit të paraleleve të ndara) në nivel të komunës. Riorganizimi i rrjetit të shkollave do të formatizohet me një vendim të veçantë të Komunës. Për menaxhim efikas të rrjetit të ri të shkollave, komuna do të sigurojë buxhetin e nevojshëm lidhur me nevojat shtesë për transportin eventual të nxënësve.

32.2 Mjedisi shkollor dhe gjithë përfshirja. Orientimi i komunës në këtë fushë të intervenimit do të jetë më shumë i fokusuar në mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese, si dhe

në ndërtimin e sallave të sportit, renovimin e fushave/terreneve sportive dhe këndeve për aktivitete rekreative, në rregullimin e rrethojave të shkollës si dhe në gjelbërimin e hapësirave shkollore.

Masa 2.1, Hapi i parë do të jetë formimi i grupit punues nga ana e drejtorit të DKA-së për rishikimin e rregullores për arsim në nivel të komunës. Dhe rishikimi i rregullores komunale për detyrat dhe disiplinën e nxënësve.

Masa 2.6, Fokusi është në rregullimin dhe ndërtimin e Sallave të sportit dhe terreneve sportive të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e orëve të edukatës fizike dhe sportive, si dhe hapësirat e tilla do të shfrytëzohen edhe nga vet banorët e lagjeve/fshatrave në terminet ku nuk pengohet procesi mësimor. Hapi i parë do të jetë identifikimi i shkollave që kanë nevojë për fusha/terrene sportive për të cilat ekziston parcela ku do të ndërtohen ato.

Niman Beqiraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, dua ta falënderoj drejtorin për këtë plan kaq të mirë, ku ka jep mundësin që asambleja dhe qytetaret të plotësojnë këtë plan me idetë e tyre, këtu shumica u than nga profesionist të fushës. Shkolla sot e ka humbur primatin në shoqërinë tonë dhe si shkaktar i kësaj është dështimi për të krijuar kushte dhe mundësi e hapësirës të nevojshme për një arsimim të tashmes dhe së ardhmes, një arsimim modern e bashkohor kryesisht kjo edhe si mungesë e masave ndëshkuese pra edhe e mësimdhënësit mirë po edhe e nxënësit do të duhet ta din se pse kanë shkuar aty unë nuk desha t'ju marr shumë kohë mirë po e kam një kërkesë të cilën nuk e pashë.

Fëmijëve me nevoja të veçanta tu kushtohet ma shumë kujdes, pra te përshihet më shumë për këtë kategori që edhe këta ta kenë me të lehtë integrimin në shoqëri, aty flitet që janë afër 28 fëmije me nevoja të veçanta të cilët janë të përfshirë në sistemin arsimor deri në vitin 2025 sipas kësaj të kaloj në 50 nxënës mirë po kjo në bazë të kornizës së veprimit nëse e morim piken e njëjtë të cilën referohet në masën 2.3 thotë diçka krejt tjetër pra 2.3 të korniza e veprimit tregon për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta, ndërkaq nëse i referohesh të masat flet për krijimin e mjediseve të veçanta për prindër dhe përfshirja e tyre në zhvillimin e shkollës. Gjithashtu kisha pasur qef një sqarim për piken 1.7 për menaxhimin efikas të rrjetit në shkolla se këtu shihet që në vitin 2025 tentohet që numri i klasave me mësim të kombinuar nga 8 të shkoj në zero që është mirë edhe numri i shkollave të punoj në një ndërrim nga 8 shkolla në 16 mirë po si e keni menduar këtë organizim a dëshironi që përmes transportit që e keni të mbyllet ndonjë shkollë sepse nëse rrihet kështu si është sigurisht që ky organizim nuk mund të ndodh.

Floriana Maxharraj – profi Florin e ka përgatitur një analizë sa i përket Draft-Planit për Zhvillim n Arsim, për shkak të vonesës së tij do tua lexoj këto propozime: kontrolla të rregullta mjekësorë për të gjithë nxënësit në komunën e Istogut në mënyrë që sëmundjet e mundshme të zbulohen me kohë edhe të merren masa ndaj tyre. Pastaj a keni menduar apo keni folur ndonjë here për sigurimin e shujtave ditore për nxënësit e shkollave fillore nga klasa e parë deri në të pestë apo edhe të klasa e nëntë nëse është e mundur financiarisht në komunën e Istogut. Kemi edhe një propozim nëse mund të hy në këtë draft në fshatin Zallq në rrugën motrat Qeriazi afër shkollës fillore Avni Rustemi gjendet një objekt i cili është jashtë përdorimit tash e disa vite objekti ka hapsir të mjaftueshme ka 5 dhoma kuzhinë dhe tualet ai është përdorur për fëmijët parashkollor por për shkak të numrit të vogël të fëmijëve tash nuk shfrytëzohet dhe fëmijët parashkollor janë bartur në objektin e shkollës fillore Avni Rustemi, nga kontaktet e banoreve për rreth duke ditur intensitetin dhe nevojën e fëmijëve kapacitetet e pakta që janë në Komunën e Istogut gjithashtu duke pasur parasysh distancën e këtyre fshatrave deri të çerdhja me e afërt në Gurrakoc është e

domosdoshme dhe në interes të të gjitha fshatrave për rreth të behe sanimi i gjendjes së objektit dhe të shndërrohet në çerdhe sipas regjistrimit të banorëve të vitit 2011 janë rreth 3mije banor që jetojnë afër e që të cilët potencialisht mund të përfitojnë nga ky investim për këtë çështje çdo gjë varët nga vullneti i komunës sepse në bazë të ligjit për arsim në Republikën e Kosovës neni 4 pika 4.1 komuna ka kompetenca të plota dhe ekzekutive për aq sa i takojnë interesit lokal. Andaj propozojmë që objekti në fjalë të shndërrohet në çerdhe.

Andi Xhuraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, në përgjithësi është hartuar një plan i mirë e kam shqyrtuar me shumë kujdes mbi të cilin kam disa sugjerime dhe vërejtje, të vendoset baza ligjore mbi të cilën është hartuar ky plan pasi që me aq sa e kam parë unë nuk është e vendosur po ashtu kemi probleme teknike të plani i zbatimit të buxhetit se është viti 2022 - 2025 i cili duhet të jetë 2023-2026, vonesa e planit pasi që ky plan është dashur të jetë i përfunduar në fillim të vitit ashtu siç parashihet.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj – falimnderon të gjithë anëtarët e kuvendit për sugjerimet dhe propozimet për këtë plan. I sqaron të gjitha pyetjet e bëra nga anëtarët e Kuvendit.

Hajrush Shoshi – është komuna e vetme që shkollat në komunën e Istogut janë të pa varura financiarisht e di që janë edhe dy komuna tjera pilot. Të gjithë buxhetin e vet shkollat e menaxhojnë dhe e shpenzojnë vet.

Florin Dreshaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, sa shpesh janë bere këto kontrole edhe a janë përfshirë të gjitha shkollat, shkollat e mesme nuk janë përfshirë dhe besoj që edhe ato është dashur të përfshihen. Edhe sa i përket çerddes ka asi që i dërgojnë në çerdhet e Gurakocit e vende të tjera por nëse hapet çerdhja aty atëherë nuk ka nevojë mi dërguar vend tjera.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj – sqaron pyetjet, në kontrolla mjekësorë nuk janë përfshirë shkollat e mesme „Haxhi Zeka” dhe „Mithat Frashri”. Sepse shkolla e mesme nuk është obligative.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush të shtoj diçka rreth këtij raporti.

Hedh në votim që të gjitha propozimet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit komisioni për hartimin e këtij Planit Zhvillimet ti shqyrtoj dhe ti vendos në Planë nëse i sheh të arsyeshme.

Hedh në miratim,

Miratohet me 14 vota për 3 vota kundër dhe 6 anëtar nuk votojnë (në sall prezent janë por nuk votojnë).

Hedhe në votim komplet Planin Zhvillimor për Arsim

Miratohet me 15 vota për 3 vota kundër, anëtarët e tjerë nuk votojnë (në sall prezent janë por nuk votojnë).

23 anëtar prezent në mbledhje

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi dhe Miratimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa, z. Genc Ademaj, benë prezantimin dhe sqarimin e Draft - Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

Arianit Selmanaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e përkrahi projekt propozimin për infrastrukturë në tabelën 4.2 fuzionomi vjetor i investimeve kapitale komunale që është me emërtim, vazhdimin e ndërtimit të kanalizimit të fazës së tretë në Kaliqan, Orroberdë dhe Studenicë me një vlerë prej 80.000.00 euro. Projekti është i qëlluar pasi zbrazja e ujërave të zeza në lagjet "Hakaj" dhe "Maksutaj" në Orroberdë po ju pamundëson banorëve atje të jetojnë në mënyrë normale. Unë i propozoj edhe disa projekte që kanë nevojë nga komuniteti andej, disa prej te cilave janë përmendur edhe në dëgjimet publike. Rregullimi dhe vendosja e trotuarit në fshatin Kaliqan deri te shkolla fillore "Haxhi Zeka" instalimi dhe vendosja e ndriçimit publik në fshatin Kaliqan, asfaltimi i rrugëve të Kaliqanit dhe disa rrugica në lagjet "Metaj" "Ukaj" "Sejdaj" "Arifaj" "Selmanaj" dhe "Cakutaj". Asfaltimi i rrugës që lidh fshatin Kaliqan me lagjen "Osmanaj" asfaltimi i rrugës për të arritur te varrezat në fshatin Kaliqan, ndërtimi i një ure që lidh lagjen "Osmanaj" me varrezat e fshatit, asfaltimi i rrugës "Pacaj" në Orroberdë, asfaltimi i rrugës "Ramqaj" në Prigodë, e kam edhe me kërkesë mundem me e dorëzuar te drejtori, ju faleminderit!

Valbonë Demaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kam një kërkesë, ne si Grup i Grave Asamblesite me mbështetje nga OSBE-ja kemi edhe bashkëpunim me disa komuna, kemi bërë Strategjinë dhe Planin e Veprimit të grupit të grave të Kuvendit Komunal të Istogut. Data 2023/2025, kështu që në këtë Plan të Veprimit përfshihen tri objektiva strategjike, promovimi i barazisë gjinore dhe politika jo diskriminuese, pjesëmarrja e gruas në vendimmarrje dhe rrjetëzimi për bashkëpunim, kërkoj që në kuadër të kësaj strategjie dhe këtij plani të ndahet një shumë, sepse të realizohen të gjitha këto projekte ka një kosto dhe kemi shkuar në bazë të komunave të tjera, kështu që vlera totale është 8700.00 euro për gjithë mandatin. Ju faleminderit!

Niman Beqiraj- faleminderit për fjalën! Gjatë këtyre dëgjimeve publike për KAB-in, kemi parë mungesë profesionalizimi sepse në lajmërimet dhe oraret për dëgjime nuk janë përfshirë të gjithë fshatrat, gjithashtu në bazë të procesverbaleve ka kërkesë vetëm nga 24 fshatra, pra nga 50 sa janë. Kjo tregon, se edhe numri i të interesuarve ka qenë i vogël, dhe pastaj buxhetimi sigurisht do të ketë shpërndarje jo të drejtë. Uroj që në të ardhmen të përfshihet edhe asambleja përmes komiteteve të veta, dhe të mos i përziejme kompetencat sepse kjo pastaj mund të ndikoj në vlerësimin e performancës. Si propozim duke parë që shpesh po përballemi me veprime të papritura, kisha kërkuar që të shikohen mundësitë ligjore që në buxhetin komunal të përfshihet edhe një fond emergjent, sepse te drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, që është pikërisht për këtë punë nuk është se është paraparë diçka tjetër përpos rrogave. Sa i përket analizës të kësaj Kornize Afatmesme Buxhetore, kemi një rritje të papërshtueshme të planifikimit buxhetor nga burimet e tjera të financimit. Pra nuk kemi një burim të qëndrueshëm financiar. Synimet gjithashtu janë edhe në kundërshtim me politikën e thirrur zhvillimore nga keq qeverisja, sepse nuk garanton zhvillim, në listën e projekteve të

KAB nuk pashë që është planifikuar diçka për zhvillim ekonomik, që ndikon në punësim apo aspekte të tjera ekonomike përveç asfaltit. Po ashtu edhe bujqësia nuk garanton zhvillim sepse si vend rural duhet të ketë përkrahje për bujq. Nuk ka as përkrahje për rininë, sportin dhe rekreacionin, kaq sa i përket komunës tonë për rininë, nuk kemi as drejtor, dhe kjo tregon seriozitetin tuaj dhe përkushtimin për rininë. Ne kërkojmë që buxheti i komunës të jetë në një shpërndarje më të drejtë, duke filluar nga respektimi i të drejtave të njeriut, duke siguruar ujë të pijes për të gjithë e më pastaj të kalohet te projektet e tjera, ne besojmë që ky plan i KAB-it nuk i përfshin të gjithë, nuk ka shpërndarje të barabartë, nuk ka prioritete siç e cek më lartë. Shumë projekte nuk kanë burim real financiar, pra nuk kanë mbulesë. Andaj unë si anëtar i Kuvendit po besoj edhe grupi i jonë i asamblistëve nuk do të përfshihen fare në këtë votim sepse nuk duam të jemi përgjegjës për këtë padrejtësi financiare. Faleminderit!

Genc Ademaj- sa i përket kërkesave të Arianitit, janë të gjitha mangësitë e investimeve të projekteve që fshati Kaliban ka nevojë, marrë parasysh mundësitë ose kufizimet buxhetore që i kemi si komunë, dhe kërkesat duhet të jenë të arsyeshme dhe reale. Në Kaliban i kemi tri projekte këtë vit, dy kanë qenë në vitin e kaluar. Janë të përfshira shumica e këtyre kërkesave që i parashtrove në dëgjime publike që i kemi mbajtur. Sa i përket Valbonës, ne jemi në kontakt edhe me zyrën edhe me udhëheqjen, bashkë i kemi caktuar nevojat edhe kërkesat edhe planifikimin e buxhetit, vitin e kaluar kane qenë 2000 euro prej kategorisë së subvencioneve, këtë vit janë paraparë 5000 euro, nëse kërkohet buxhet shtesë patjetër që do të ju përkrahim.

Fjolla Ukaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Si anëtare e komitetit për Barazi Gjinore duke parë nga afër punën dhe aktivitetin që bëjnë kjo zyre , dhe duke parë rritjen e aktiviteteve nga zyrtarja për të drejtat e fëmijëve, atëherë propozoj që kësaj zyre ti ndahet një buxhet shtesë prej 3000 euro. Ndërsa sa i përket ndarjes buxhetore, pjesës nga Banja dhe fshatrat përreth te pjesa e ndriçimit publik, besoj edhe drejtori e ka bërë një zotim publik, kam kërkuar që zona prej shkollës është errët sidomos gjatë stinës së dimrit. Kisha rekomanduar që te ndërtimi i trotuareve prioritet të jetë nga Onix-i e deri te kryqëzimi i ambulantes. Faleminderit!

Andi Xhuraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë i kam disa propozime, i pari është që të hyj në KAB rruga “Bekë Bali” për asfaltim në Studenicë, propozimi i dytë është ndriçimi i lagjes në qendrën e qytetit rruga “Drita e parë” po ashtu platoja, dhe si propozim të fundit prej stadiumit e deri te Off On të vendosen disa policë të vdekur. Faleminderit!

Ajshe Metaj- ajo çfarë dua të flas rreth projekteve kapitale është çështja e kanalizimit të fshatit Saradran lagjia e Llugave, e di që për këtë vit nuk mund të realizohet por propozoj që në këtë fshat të shtrihet kanalizimi. Propozoj pra që projektet që nuk mund të realizohen ne vitin 2024 të vazhdojnë edhe në vitin 2025. Propozoj që të vazhdoj kanalizmi për lagjen “Osmanaj” “Maloku”, “Gashi”, “Kabashi”, “Miftaraj” ,“Nikqi” ,“Madanaj” ,“Mustafaj” ,“Tafilaj” “Hetemaj” dhe “Dërdallaj”. Ju faleminderit!

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Falënderoj kryetarin dhe ekzekutivin sepse neve si anëtarë të Kuvendit na kanë liruar shumë nga propozimet duke mbajtur dëgjime publike. E përshëndes këtë iniciativë të kryetarit dhe të vazhdohet në këtë metodë. Kështu të gjithë së bashku si ekzekutivi si ne si anëtarë të Kuvendit kur të vijë

koha do ta bëjmë një buxhet ashtu si na ka hije. Unë si Haki i kam dy propozime. Asfaltimi i një rruge në lagjen "Osmanaj" prej 200m dhe trasimi i rrugës në Carallukë, e lidh rrugën "Niman Podrimaj" me rrugën "Daut Zagragja" 800m. Ju faleminderit"

Faruk Kabashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë kam një kërkesë të vogël, në vitin 2023-2025 ka qenë asfaltimi i rrugës në Gurrakoc, rruga "Niman Kabashi" tani në 2024-2026 nuk është. Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- ftoj drejtorin të përgjigjet në pyetjet e juaja.

Genc Ademaj- po filloj me Nimanin, te drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, the nuk ka buxhet përveç pagave, ja ku e ke tabelën 4.1, kjo drejtori e ka kodin e vet, i ka të ndara 80.000 euro nga mallra dhe shërbime dhe 40.000 euro subvencione. Arsyeja se ti nuk e sheh është sepse nuk figuron kërkesa për vitin aktual sepse kërkesën e kemi bërë këtë vit. Vitin tjetër do këtë kodin e vet dhe burimet e financimit dhe projektet e veta. Te kultura që e ke cekur, dhe shpërndarja e buxhetit në kategori, nuk e kemi bërë ne vet këtë planifikim, ka rrjedh prej kërkesave të qytetarëve. Te pjesa e zhvillimit për krijimin e vendeve të punës, të gjitha këto projekte shkojnë për me krijuar mundësinë e infrastrukturës, të kanalizimit, të rrjetit që ndërmarrjet të zhvillohen dhe të krijojnë vende të reja të punës. Te shërbimet publike, ka buxhet pak më shumë se te drejtoritë tjera për shkak të shërbimeve që kryejnë. Është drejtoria që ka më së shumti kërkesa. Faruk, te pjesa e rrugëve që i përmende në Gurrakoc ato përfundojnë këtë vit. Te pjesa e ndriçimit në Banjë ajo realizohet këtë vit. Te pjesa e Zyrës për Barazi Gjimore apo si e ceke ti Fjollë, për të drejtat e fëmijëve ka buxhet të mjaftueshëm. I shikojmë mundësitë nëse ka kërkesë prej Zyrës në anën zyrtare unë e pranoj dhe e bëjmë shtimin e buxhetit.

Niman Beqiraj- faleminderit kryesues për fjalën dhe drejtor për sqarimet. Ky është një dokument strategjik që vjen nga kërkesat e qytetarëve, e thashë edhe më herët që ka pasur jo profesionalizëm në këto dëgjime. P.sh lajmërimet për këto dëgjime nuk i kanë përfshirë të gjitha fshatrat, p.sh Dragolec, Tuqep, Llukac i Thatë etj. Tjetra, nëse nuk i ke të përfshira të gjitha fshatrat si mundesh ti marrësh kërkesat prej gjithë qytetarëve nëse nuk e bën një planifikim të mëhershëm. Asnjë kërkesë nuk ishte për ujë të pijes pra për ujësjellës. Këto dëgjime publike siç i kam lexuar unë nga 50 fshatra sa janë vetëm nga 24 fshatra ka kërkesa. Është mirë me i marrë kërkesat por duhet të kesh edhe orientim se nga të shkosh. Tek kodi buxhetor që e përmende te drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim në këtë strategji nuk është, është mirë që e keni ndarë. Mirë që një milion euro i keni thith, por duhet të tregoni se edhe një milionë i keni dërguar në suficit. Gjithashtu nuk e di a është marrë parasysh që në këto dëgjime publike shumica e pjesëmarrësve nuk kanë qenë gra, a është i përfshirë edhe buxhetimi gjinor. Ju faleminderit!

Genc Ademaj- ne jemi duke folur për vitet në vijim dhe jo vitin aktual, ta shpjegova në detaje më herët. Te pjesa e ujësjellësit nuk na liron neve përgjegjësia për me i shërbyer qytetarëve nëse ata kanë nevojë për ndihmë. Rasti i fundit kur kemi pasur vërshime në Vojdullë komplet gypi është dëmtuar dhe "Hidrodrini" nuk ka pasur kapacitete ta rregullojë dhe e kemi rregulluar ne si komunë edhe pse nuk është përgjegjësi e jona. Te planifikimi ta sqaroja se nuk lejohet planifikim i buxhetit komunal për investimin e ujësjellësve është aset i ndërmarrjeve publike rajonale "Hidrodrini". Kemi marrë shkresë vitin e kaluar që nuk aprovohen projektet të cilat kanë të bëjnë me investime në rrjet të ujësjellësit. Te çështja e planifikimeve të projekteve kryesore, po ne i zhvillojmë politikat

për projektet kryesore, p.sh si te rasti që e përmendi Arianiti që tha po më vjen mirë projekti kryesor për ndërtimin e kolektorit se i grumbullon ujërat e zeza të më shumë se tre katër fshatrave të anës perëndimore. Unë mendoj që planifikimi është shumë transparent. T'i planifikojmë bashkë me juve projektet që janë më urgjente e jo të bëjmë projekte që nuk janë shumë urgjente.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! A ka edhe dikush të diskutojë rreth kësaj pike? Pasi që nuk ka, e hedhim në votim Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026. Kush është për?

Konstatohet që nga 22 anëtarë të Kuvendit me 15 vota për dhe 7 abstenim miratohet Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

Të pranishëm 22 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken radhës, Shqyrtimi dhe Miratimi i listës për projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2023.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa, z. Genc Ademaj - benë prezantimin dhe sqarimin të listës për projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2023.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapim debatin rreth kësaj pike? A dëshiron dikush ta marrë fjalën? Atëherë pasi që nuk ka diskutime, e hedh në votim, kush është që të miratohet pika e rendit të ditës, 'Lista për projekte të reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2023.

A ka dikush diçka?

Pasi që diskutime tjera nuk ka

Hedh në votim

Miratohet unanim

Konstatohet që 20 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e fundit Pyetje nga anëtarët e Kuvendit. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Negjdet Ramaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kam një propozim, që në sheshin "Ibrahim Rugova" përballë zyrës së Veteranëve të vendoset shtatorja e heroit të Kombit Selman Kadria, ne si qytetarë të Istogut jemi mburrur gjithmonë me figurën e Selmon Kadrisë dhe e kemi pas si udhërrëfyes edhe nëpër beteja gjatë luftërave të fundit.

A ka mundësi me na treguar në cilat ligje apo rregullore jeni bazuar kur keni marrë vendim me i demoluar rrethojat e xhamisë në Istog, e cila ishte e rrethuar me tel të zingum dhe nuk ishte me e gjatë se 1m e 50 cm.

Ju jeni thirrur në parimin që objektet fetare duhet me qenë të hapura, pyetja ime është, kur do t'i largoni rrethojat e kishave sllave serbe sidomos rrethojën e kishës në qendër të Istogut.

Po më intereson a janë duke vazhduar punimet në stadiumin "Demush Mavraj" dhe a keni marrë përgjigje nga ministria në lidhje me kompensimin e pronës e cila është paraqitur si pengesë për vazhdimin e punimeve në atë pjesë.

E kam edhe një shqetësim në lidhje me prerjen e lisave në qytet, sa herë po bëhet një intervenim në rrugët e qytetit, aty po bëhet një masakër e drunjëve, a keni menduar që në të ardhmen me i punuar rrugët pa i shkatërruar drunjët?

Genc Ademaj-sa i përket pyetjes së parë së vendosjes së shtatores të "Selman Kadrisë" para zyrës së veteranëve të sheshi, ne ende jemi në fazën e matjes të asaj rruge se a do të mbetet shesh apo do të lëshohet në qarkullim, besoj ka fundi i vitit do ta kemi një rezultat prej ekspertëve të komunikacionit. Pas rezultatit të tyre mund ta shikojmë mundësinë, edhe pse është shumë e vështirë në atë lokacion të vendoset ndonjë lapidar apo përmendore.

Te rrethojat e objekteve fetare, sa për informacion, xhamia në Istog nuk e ka në fletën poseduese si pronë të vetën, po flas për xhaminë e re, sepse të xhamia vjetër e kemi ndërtuar rrethojën. Kështu që të xhamia re komplet përgjegjësinë e mban hoxha i xhamisë i cili pa ndonjë konsultim paraprak me drejtorinë për urbanizëm planifikim dhe mjedis ka vendosur rrethoja. Me herët ka qenë për momentin nuk është. Hoxha është dashur të vijë në komunë me e bërë një kërkesë zyrtare, edhe mu pajis me leje edhe të shkoj ta ndërtoj atë rrethojë. Vet hoxha ka dhënë pëlqimin që oborri i xhamisë të jetë në parkun e qytetit, e që parku mirëmbahet nga komuna

Negjdet ta japi një sqarim, në vitin 2021 dhe 2022 të gjithë infrastrukturën, komplet nevojat e xhamisë së re i ka kryer komuna, e këto hoxha nuk po i përmend, ne kemi investuar në oborr të xhamisë. Ne kemi pasur konsideratë për veprimin e hoxhës që e ka bërë aty si institucion sepse kemi përgjegjësi ligjore edhe për mosveprim. Kemi biseduar me të dhe prapë ka vepruar kokë në vete, pa konsultim edhe me kryesi. Nëse e bën një kërkesë siç duhet do miratohet, vendosen rrethojat, sepse ka dashur ta kufizoj hapësirën ka dashur ta vendos derën nuk e paske këtë informacion. Asnjë nga të gjithë ne këtu nuk jemi kundër xhamisë, është i padrejtë ky adresim, dhe kjo goditje politike që sa ditë që po i bëhet komunës së Istogut. Rrethoja është larguar vetëm për një arsye sepse ka qenë ndërtim pa leje në parkun e qytetit. Xhamia e re në Istog është e ndërtuar në pronën komunale.

Sa i përket pjesës të uji i pijes, për pjesën e mbi vadës të gjitha punimet kanë përfunduar vetëm të lidhja në kaptazhet të burimi, nuk po mundemi me e realizuar për shkak të sasisë së madhe të ujit që e ka burimi i Istogut për momentin. Kjo është arsyeja e vetme.

Kryesuesi i Kuvendit- të çështja e xhamisë Negjdet sepse kam qenë një mandat drejtor i Shërbimeve Publike, si kam ardhur drejtor jam emëruar në vitin 2018 për ndërtimin e kalldasë për xhaminë e re, i ka ndarë komuna 5.000 euro, komplet ndriçimin, kompania për ndriçimin publik në komunë i ka ndërruar të gjitha të gjithë poqët dhe kokat rreth xhamisë, komplet ndriçimi bëhet nga fondi komunal, pastaj edhe drejtori e ka bërë një pagesë të energjisë elektrike. Pra si komunë nuk kemi kursyer asnjëherë.

Genc Ademaj- kryesues i kam mbetur borxh Negjdetit edhe të pjesa e stadiumit "Demush Mavraj" punimet janë ndalur për shkak të problemeve pronësore siç je i njoftuar edhe ti, ka qenë një marrëveshje gojore për një pronë që ka qenë e shfrytëzuar

nga komuna e Istogut që nga ndërtimi i stadiumit të qytetit qysh nga viti 2003-2004 dhe në momentin që ne kemi dashur të vazhdojmë me punime, ka dalë që është një kontekst pronësor, i kemi marrë të gjitha masat për rregullimin e shpronësimit, lënda për momentin është në ministrinë e Financave. Janë të obliguar që brenda 40 ditëve të kthejnë një përgjigje pra presim brenda muajit korrik përgjigjen nga ana e tyre. Ju faleminderit!

Andi Xhuraj- faleminderit për fjalën kryesuesi! E kam një pyetje për drejtorin e DKA-së z. Naim Behlulaj. Tash e 5 muaj, në këtë sallë i ke pasur prezentë rreth 100 bursistë me të cilët ke bërë foto, i keni postuar ne rrjete sociale, e tash e 5 muaj nuk janë ekzekutuar pagesat. Kështu që nëse mundesh me na treguar saktësisht, kur planifikoni të ekzekutoni. Faleminderit!

Genc Ademaj- për shkak të ngritjes së numrit, ose dyfishimit të bursave, besoj që në Kuvendin e kaluar e kemi marrë një vendim për rritjen e subvencioneve të pjesa e arsimit, ka qenë kryesisht për ngritjen dhe mundësinë e pagesës së bursave që janë 134 nëse nuk gaboj për të cilat ka mjete të mjaftueshme, i kemi dërguar sepse procedura thotë që duhet të regjistrohen si furnitorë në ministrinë e Financave. Besoj që deri ka mesi i Korrikut të gjitha pagesat do të ekzekutohen.

Floriana Maxharraj- faleminderit kryesues për fjalën! E kam një kërkesë prej një banori që jeton në fshatin Dobrushë, Muhamet Nikqi, ka bërë kërkesë për shtrimin e një rruge me zhavorr dhe nuk ka marrë ende përgjigje. Kryesues me duhet edhe një sqarim për pikën e rendit të ditës që e kam propozuar dhe nuk u diskutua për të?

Abedin Kabashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Lidhur me kërkesën që e parashtrove, realisht ajo është aprovuar, sikur të gjitha kërkesat tjera që kanë kërkuar për shtrimin e zhavorrit, dhe këto ditë fillojmë me shpërndarjen e zhavorrit nëpër këto rrugë. Kjo ka ndodhur për arsye që nuk e kemi lidhur kontratën për zhavorr.

Genc Ademaj- atëherë për pyetjen që e patëm në fillim të kësaj mbledhje, siç e potencoi edhe kryetari, është edhe një premtim i fushatës nga vet kryetari. Unë kam bërë disa herë analiza se si të sigurohen fondet për me e trajtuar. Mesatarisht komuna e Istogut ka lindje vjetore 320 deri 250 lindje të reja, vitin e kaluar kanë qenë 286, po hymë në këtë mesatare. Bazuar në masën 3.5 që është në fuqi që është marrë nga qeveria dhe ministria e Financave ku gratë lehona përkrahen që 12 muajt e fundit që kanë qenë të papuna të lajmërohen në entin e punësimit ato përfitojnë për 6 muaj rreth 170.00 euro, ndërsa për lehonat që janë në marrëdhënie pune ato përfitojnë për 3 muaj rresht 170.00 euro. Propozimi i juaj prej 300 euro për nënat lehona, nëse e kalkulojmë kjo duhet të paguhet nga kategoria subvencione dhe transfere. Po supozojmë që brenda vitit i kemi 350 lindje here 300.00 euro përkrahje janë 90.000.00 euro subvencione vetëm për këtë kategori. Nëse e marrim për bazë përkrahjen e qeverisë për lehonat që janë në marrëdhënie pune për tre muaj nga 170.00 euro, atëherë vlera totale e përkrahjes është 580.00 euro. Nëse shkojmë me një kosto me të vogël si fillim që me e bë si pjesë të masës 3.5 siç e ka edhe ministria, atëherë jemi të obliguar të fillojmë me 100.00 euro, unë e kam bërë edhe një kërkesë, tash kur te na vjen qarkorja përfundimtare mundem edhe me ja filluar aplikimin përndryshe rritja e subvencioneve nuk miratohet çdoherë nga ministria e Financave. Ndoshta ka 2025 mundemi ta rrisim kategorinë e subvencioneve për me e

përkrah. Edhe ne jemi për ,po nuk po mundemi me i siguruar fondet e mjaftueshme dhe me e realizuar atë ngritje të nevojshme për përkrahjen e nënave lehona. Ju faleminderit!

Ajshe Metaj – kam një krekës të cilën e kam pasur edhe mandatin e kaluar rreth ngritjes së një obilisku të sheshi i gjakut sepse dihet aty kanë ra një numër i personaliteteve dhe të njerëzve që kanë dhënë gjakun për ditët e sotme, dihet mire së historia nuk është veç sot por edhe me herët prandaj konsideroj që meritojnë që të ngritet një obelist dhe të evidentohen emrat e atyre njerëzve që në mënyrën me mizore ju ka marr jeta të Sheshi i Gjakut.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa, z. Genc Ademaj – kjo krekës është shumë me vend e kemi analizuar jemi duke e bërë një planifikim detal të kullës famëkeqe që ka qen aty të cilën po mendojmë me e ndërtuar si muze. Deri ka fundi i vitit në bazë të fotove që i kanë sjellë qytetaret për me bërë riprojektimin e asaj kulle ka me qen në dispozicion ku pjesa e brendshme është planifikuar të jetë një formë e muzeut ku paraqiten torturat që i ka vuajtur populli shqiptar ndër shekuj.

Niman Beqiraj – kam tri pyetje dhe një kritik: pyetja e par ka të bëjë me një krekës elementare siç është uji për fshatin Veriq dhe lagjet „Boletini, Igrishtaj, Geci, Ahmetaj, Haxhijaj dhe Fekaj” mbi 40 familje dhe ekonomi familjare tash e 23 vite nuk kanë ujë dhe detyrohen të shërbehen me ujë si kohet e kaluara duke e bartur me kanta gjatë bisedave me banor të kësaj zone thonë që sistemi është i shtrirë por ka mungesë të ujit ani pse burimi i ka 2500 litra për sekondë, as një here nuk është ndërmarr diçka në këtë drejtim dhe pas shumë premtimeve elektorale sipas tyre kur do t’ju behet një zgjidhje që edhe këta të kenë qasje në uji të pishëm.

Krekës nga banoret që banojnë në objektet banesore të shtetit e që gjinden afër bustit të dëshmorëve „Arben Januzaj” në Istog këto ditë kemi qen dëshmitar që ka pasur shira të mëdha dhe uji ka depërtuar e ka bërë të pa jetueshme jetën për ata banor aty unë isha brenda të disa familjeve dhe e pash që nuk kishin kushte të mjaftueshme për shkak të lagështisë aty, i kam bërë edhe disa foto (tregon fotot) ku shihen që dhomat janë të mbuluara me najlon dhe kofe ka gjithandej kjo mund të jetë rrezik dhe mund të ketë pasoja edhe për sistemin e rrymës. Nga jashtë kulmi i këtij objekti shihet që është i shkatërruar kështu se paraqet rrezik për kalimtarët e tjerë nga ramja e ndonjë tjegulle edhe përveç tjerash është marrë edhe me e pa dikush që është nga Istogu atë pamje është i vetmi vend në botë që tjegulla rrinë në formë vertikale (tregon fotot) shumë letë mund ti bie dikujt dhe ta dëmtoj.

Qentë endacak e dimë që është problem vendi dhe përmendet shpesh mirë po kam krekës nga prindërit për qentë që rrinë kryesisht afër shkollave nuk guxojnë ti lejojnë fëmijët vetë nga qentë endacak kryesisht afër shkollës „Bajram Curri” .

Kritika ka të bëjë me ndihmat sociale se po shkepen ditën e Bajramit ato 60 pako që u shkepen e përkrahim këtë iniciativë është mirë që ndihmat sociale ti ipen qytetarëve nga buxheti i komunës dhe tu dilet ndihem në këtë kohë, mirë po nuk është mirë që të shfaqen fytyrat e tyre para kamerave mos ti humbim dinjitetin qytetarit. Sepse siç ka të drejta drejtoresh në buxhetin ashtu kanë edhe ata, nuk është mirë ti dilet fytyra.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Buxhet e Financa, z. Genc Ademaj – sa i përket sistemit të ujit është projekti që fshati Veriq me u lidh me fshatin Kovrag në sistem që në mënyrë me u krijuar unaza e qarkullimit që me u leshu uji në dy fshatrat i di problemet

e tyre. Të banesat sociale afër xhamisë është e planifikuar renovimi në total i banesës për këtë vite. Për qentë endacak javën e kaluar është nënshkruar kontrata dhe besoj se shumë shpejt do të rifilloj trajtimi i tyre.

Florin Dreshaj - kam një vërejtje për koleget që po ikin nga seanca se po i marrin gati 200 euro për një orë që po punojnë ku llogaritet 200 euro orën edhe me ik është goxha e pa ndershme.

Dua të diskutoj për çështjen e dëshmorëve të komunës së Istogut është çështje goxha e ndjeshme, po ndihna shumë në siklet por është kërkesë e familjareve që listat e emrave që i kanë qit me i hek pllakat deri sa të kryhet gjyqi. Nuk e di kut ti bej pyetje sepse nuk e di kush është marr me atë çështje por nuk e di në çka janë bazuar që i kanë qit 63 emra mendoj që është bere gabim shumë i madhe pasi që çështja ka qen në prokurori është dashur me pritë deri sa gjykata të marr një vendim edhe me e qit listën e emrave tash disa familjar i kanë fshi emrat e familjareve të vet dëshmor edhe një numër tjetër kanë me ardh me i fshi djali i mixhës tim kanë me ardhë me i fshi emrat sepse ata po konsiderojnë po me vjen keq edhe m e thëne numri të cilët janë shtuar nuk janë dëshmor por janë martir bile është bere gabim shumë i madhe KLDNJJ-a.

Kryesuesi i Kuvendit – kam vërejtje për anëtarët që kanë lëshuar mbledhjen, nuk po e respektojnë votat e qytetarëve

Falënderon për ju të gjithë që patet durimin të qëndroni deri në fund të mbledhjes, dhe dhatë kontributin e juaj,

E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.

Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:25

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj

Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

